



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”) dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për hapjen dhe funksionalizimin e tregut

1. Me këtë vendim hapet dhe funksionalizohet tregu pranë Shtëpisë së Verës (Tregut të Rrushit) për shitjen e prodhimeve bujqësore, kulturave perimtare, produkteve të bylmetit të gatshme për treg.
2. Fermerët të cilët do ti ekspozojnë produktet e tyre në treg obligohen që t’i respektojnë rekomandimet e IKSHP-së kundër COVID-19 siç janë: mbajtja e distancës sociale prej 2 metra dhe përdorimi i maskave dhe dorëzave.
3. Fermerët të cilët nuk e kanë prezent Numrin Identifikues të Fermerit (NIF) dhe të cilët nuk pajisen me masat mbrojtëse sipas pikës 2 të këtij vendimi nuk mund t’i ekspozojnë dhe shesin produktet e tyre në treg.
4. Obligohet Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që të hartoj Planin Operativ për funksionimin e tregut siç është: caktimi i orarit për shitjen dhe llojin e produktit.
5. Obligohet Drejtoria për Inspektim dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që të bëjnë inspektimin dhe mbarëvajtjen e funksionimit të tregut.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh gjendjen e krijuar në Republikën e Kosovës pas paraqitjes së pandemisë së CoronaVirus COVID-19 si dhe mungesës së tregjeve për ekspozimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore nga ana e fermerëve të Komunës së Rahovecit, është parë e arsyeshme që hapësira e tregut pranë Shtëpisë së Verës (Tregut të Rrushit), në një hapësirë prej 1 hektarë e 10 ari, parkingut të mjaftueshëm që është i ndarë nga tregu në relacionin Rahovec - Xërxë, të hapet dhe të funksionalizohet për t’iu mundësuar fermerëve të Komunës së Rahovecit ekspozimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore, shitjen e kulturave perimtare dhe shitjen e produkteve të bylmetit.

Duke marrë parasysh hapësirën e mjaftueshme të tregut të lartëcekur, konsiderojmë se bujqit e komunës së Rahovecit do të mund t’i ekspozojnë dhe shesin produktet e tyre duke respektuar mjaftueshëm masat e rekomanduara nga IKSHP për mbajtje të distancës, maskave dhe dorëzave.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës për Informim,
- Stacionit Policor në Rahovec,
- Drejtorië për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Drejtorisë për Inspektim, dhe
- Arkivit.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
ADMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 607 Nr. i faq./Br.str./No pg 61
Data/Datum/Date 05/05/2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

